

FILMI SHQIPTAR NË GAZETËN DRITA

Prof.Asoc.Dr. Loreta Zela (Axfami)

Dr. Raimonda Nelku

1. HYRJE

Gjatë periudhës së regjimit komunist në Shqipëri (1945-1990), jeta kulturore dhe intelektuale ishte nën kontrollin dhe ndikimin e ideologjisë komuniste. Censura dhe autocensura luajtën një rol kyç në përcaktimin e asaj që mund të krijohej, publikohej apo promovohet në fushën e artit, kulturës dhe medias. Në këtë kuadër, gazeta kulturore "Drita" dhe Kinostudio "Shqipëria e Re" u pozicionuan si dy shtylla thelbësore të propagandës shtetërore në kulturë, duke reflektuar ideologjinë komuniste në dy forma të ndryshme, por komplementare: fjalën e shkruar dhe imazhin viziv.

Gazeta "Drita" shërbeu si një forum për kritikën letrare dhe artistike, ku shkrimet dhe analizat promovonin vlerat e realizmit socialist dhe mesazhet politike të kohës. Ajo ishte një instrument që jo vetëm përcillte por edhe mbështeste direktivat e pushtetit, duke ndikuar thellë në perceptimin e publikut mbi letërsinë dhe artet. Nga ana tjetër, Kinostudio "Shqipëria e Re" funksionoi si platforma vizuale kryesore për të transmetuar propagandën përmes kinematografisë, duke krijuar një narrativë të orkestruar që pasqyronte ndryshimet politike, shoqërore dhe ekonomike të periudhës.

Ky projekt synon të hedhë dritë mbi ndikimin e gazetës Drita në formësimin e kulturës shqiptare të asaj kohe, duke analizuar ndërveprimin midis letërsisë, kinematografisë dhe medias si mjet komunikimi ideologjik.

2. METODOLOGJIA, PYETJET KËRKIMORE DHE RISHIKIMI I LITERATURËS

Objektivi i kërkimit: Si kanë evoluar teknikat propagandistike në gazetën Drita, seksioni i filmit artistik shqiptar, sipas periudhave historike në harkun kohor 1961-1990?

Pyetjet kërkimore kryesore:

- Cilat janë tematikat kyçe të përdorur në artikuj sipas fazave historike?
- Cilat janë framet kyçe të përdorura në artikujt sipas fazave historike?
- Cilët janë togfjalëshat kyç më të përdorur në faza të ndryshme historike dhe si kanë ndikuar ato?
- Si ndryshoi toni dhe gjuha e përdorur për të përcjellë mesazhe ideologjike sipas këtyre fazave dhe si ndikuan ato?

Studimi mbështetet në kombinimin e metodave shkencore sasiore e cilësore me atë krahasuese. Gjithashtu është bërë desk research për t'u qasur burimeve dhe dokumentacionit të dorës së parë,

siç janë gazeta Drita periudha 1961-1990, filmografia që i korespondon të njëjtës periudhë (**202 filma**); dokumenta nga Arkivi Qendror i Shtetit, Dosje të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, Arkivi Qendror i Filmit Shqiptar.

Janë shfletuar **mbi 1600 numra të gazetës** Drita të botuara **në harkun kohor 1961-1990**. Kjo periudhë ndahet në 6 nënperiudha me qëllim që të kapen ndryshimet. (Këtu i referohemi pleniumeve të KQPPSH dhe direktivave të tyre për ndryshimet dhe specifikat e çdo periudhe. Për të identifikuar, ngjarjet si pikëkthese brenda specifikave të kuadrit kohor të dhënë.)

Janë analizuar **586 artikuj** të zhanreve të ndryshme mbi çështje të artit e kulturës dhe filmit artistik shqiptar.

Janë realizuar **10 intervista të strukturuar** në isa nivele: ish-redaktorë dhe gazetarë të gazetës Drita, kineastë, zyrtarë të ish KQPPSH, apo me gazetarë bashkëpunëtorë të gazetës Drita, studiues të medias.

Për të realizuar studimin është shfrytëzuar një spektër teorik komplementar që i përshtatet metodologjisë së studimit. Jemi fokusuar në teoritë e propagandës dhe manipulimit të masave, si dhe qasjet mbi totalitarizmin dhe mediat e kontrolluara shtetërore; teorinë e agjendës së shtypit me qëllim manipulimin e opinioneve si dhe teorinë e framtë si dhe diskursit ideologjik duke krijuar përmes kritikës së filmit një narrativë propogandistike.

Janë disa autorë europian që kanë trajtuar modelet e propagandës si Lasswell, Arendt, Ellyl, Katz, por në një formë të aktualizuar ato për rastin shqiptar i sjell prof. Artan Fuga në një seri studimesh mbi propagandën dhe manipulimin përmes shtypit shqiptar në periudhën e regjimit komunist.

Metoda sistematike e Lasswellit është zbatuar për kodimin e të dhënave me qëllim zbulimin e temave, modeleve dhe teknikave të përsëritura të propagandës. Bazuar në këtë metodë, është bërë: a) kodimi/identifikimi dhe kategorizimi i qartë i temave duke i ndarë në njësi kuptimore; b) identifikimi i fjalëve/togfjalëshave kyç që përsëriten me qëllim theksimin e mesazheve të caktuara propogandistike; c) frekuenca e përdorimit të togfjalëshave kyç për të zbuluar përhapjen e ndikimit propogandistik, d) toni emocional, dmth ngarkesa emocionale e artikullit (pozitive, negative ose neutral); si vjen toni përmes fjalëve të përzgjedhura, stilit dhe mënyrës se si prezantohet informacioni për të analizuar ndikimin psikologjik të propagandës.

Analiza e kornizës mbështetet në modelet teorike të prezantuara nga Goffman (1974) dhe Entman (1993) sipas të cilave kornizat janë "kutitë" konceptuale që media krijon për të prezantuar një histori ose një temë.

3. GJETJE SASIORE DHE CILËSORE

3.1 Specifika të artikujve mbi filmin sipas periudhave historike

Periudha 1986-1990 shënon përqindjen më të madhe të artikujve të publikuar mbi filmin, specifikisht 21.7% të totalit, periudhë gjatë së cilës prodhimi vjetor kinematografik arriti mesatarisht 14 filma artistikë në vit. Periudha e dytë me përqindjen më të lartë të artikujve është në vitet 1976-1980, me 21.3% të totalit, çka përkon edhe me rekordin e filmave artistik të

prodhuar në një vit kalendarik, konkretisht në vitin 1979 me 16 filma. Përqindja më e ulët e artikujve të publikuar në gazetë është në vitet 1961-1965 me 5.6 % të artikujve, periudhë që konsiderohet fillestare në kinematografinë shqiptare. Shifrat tregojnë se publikimi i artikujve për filmin artistik ishte në të njëjtën linjë me prodhimtarinë e kinematografisë shqiptare.

1.3 Artikuj sipas periudhave historike, 1961-1990

Periudha historike	Nr.	%
1961-1965 (Plani i 3 pesëvjeçar)	33	5.6%
1966-1970 (Plani i 4 pesëvjeçar)	58	9.9%
1971-1975 (Plani i 5 pesëvjeçar)	120	20.5%
1976 -1980 (Plani 6 pesëvjeçar)	125	21.3%
1981-1985 (Plani i 7 pesëvjeçar)	123	21.0%
1986-1990 (Plani i 8 pesëvjeçar)	127	21.7%
<i>Total</i>	<i>586</i>	<i>100.0%</i>

Shumica e artikujve të publikuar, afërsisht rreth 70% janë për filma specifike, ndërsa rreth 30% janë për çështje të filmit dhe kinematografisë në përgjithësi.

1.4 Artikuj të botuar për problematikat e filmit në përgjithësi apo filma specifike

	Nr.	%
Filma specifike	403	68.8%
Për filma në përgjithësi	183	31.2%
<i>Total</i>	<i>586</i>	<i>100.0%</i>

Vetëm 25.8% e artikujve mbi filmin janë publikuar në faqen e parë të gazetës Drita ndërsa 74.2% e artikujve janë në faqet e brendshme.

Në periudhën 1986-1990 janë publikuar më shumë artikuj në faqen e parë, specifikisht 21.9% ndërsa periudha 1961-1965 përfaqëson vlerën më të ulët, 11.9%.

1.6 Artikuj në faqen kryesore apo jo sipas periudhave historike							
	1961-1965 (Plani i 3 pesëvjeçar)	1966-1970 (Plani i 4 pesëvjeçar)	1971-1975 (Plani i 5 pesëvjeçar)	1976-1980 (Plani 6 pesëvjeçar)	1981-1985 (Plani i 7 pesëvjeçar)	1986-1990 (Plani i 8 pesëvjeçar)	Total
	Nr.						
Po	18	24	28	19	29	33	151
Jo	15	34	94	104	95	93	435
	%						
Po	11.9%	15.9%	18.5%	12.8%	19.2%	21.9%	100.0%
Jo	3.4%	7.8%	21.6%	23.9%	21.8%	21.4%	100.0%

Më shumë se gjysma e artikujve, 55.3% janë të ilustruar me fotografi kundrejt 42% të pailustruar vizualisht.

2. Artikuj sipas shoqërimit vizual

Shoqërimi vizual	Nr.	%
Fotografi	324	55.3%
Ilustrim grafik	16	2.7%
Jo	246	42.0%
<i>Total</i>	<i>586</i>	<i>100.0%</i>

Zhanri më i lëvruar gjatë periudhës 1961-1990 është Artikulli kritik/recensionimi me 57% të totalit e pasuar nga 'Lajmi' me 10.9%. Të dhënat tregojnë rëndësinë e madhe që kishin artikujt kritikë të filmit në raport me zhanret e tjera gazetareske edhe si instrument përforcues i propagandës në shërbim të regjimit komunist.

3. Zhanri i shkrimit		
Zhanri i shkrimit	Nr.	%
Artikull kritik	334	57.0%
Editorial	8	1.4%
Fjalime të botuara	22	3.8%
Intervistë	34	5.8%
Kronikë	60	10.2%
Lajm	64	10.9%
Profil	21	3.6%
Referate të botuara	9	1.5%
Opinion	4	0.7%
Bisedë	3	0.5%
Raport	3	0.5%
Reportazh	2	0.3%
Shënime	2	0.3%
Tjetër	20	3.4%
<i>Total</i>	586	100.0%

Shumica e artikujve, 86.6 % kanë për autorësi redaksinë e gazetës, kundrejt 8.2% korrespondent dhe 5.1% bashkëpunëtor të jashtëm.

5. Autorësia e shkrimit		
Autorësia e shkrimit	Nr.	%
Redaksia	506	86.6%
Korrespondent i gazetës Drita	48	8.2%
Bashkëpunëtor i jashtëm	30	5.1%
<i>Total</i>	584	100.0%

3.2 Framet sipas periudhave historike

Periudha 1961-1965: Gjatë kësaj periudhe frame-t mbizotërues të artikujve janë: Materializmi dialektik me 25.8%; Kritika dhe autokritika me 19.2%; Kritikë ndaj kapitalizmit 17.6%; Lufta kundër kulturës borgjeze 15.5%; ndërsa asnjë prej artikujve nuk i përket frame-t ‘Konformizmi vs integriteti krijues’ dhe ‘Devijues nga këto korniza’.

6.1 Frame-t e artikujve sipas periudhave historike (Më shumë se një përgjigje)							
Frame-t	1961-1965 (Plani i 3 pesëvjeçar)	1966-1970 (Plani i 4 pesëvjeçar)	1971-1975 (Plani i 5 pesëvjeçar)	1976-1980 (Plani 6 pesëvjeçar)	1981-1985 (Plani i 7 pesëvjeçar)	1986-1990 (Plani i 8 pesëvjeçar)	Total
Nr.							
Materializmi Dialektik	16	19	10	7	6	4	62
Parimet e realizmit socialist si janë ndjekur	20	34	43	28	26	26	177
Partia dhe roli i intelektualëve	16	27	29	23	18	19	132
Emancipimi masës, roli i artit në transformimin e shoqërisë	17	32	41	41	55	57	243
Lufta kundër kulturës borgjeze	15	27	27	23	3	1	96
Kritika dhe autokritika	15	16	26	7	2	12	78
Estetika e kolektivizmit	1	0	4	14	8	5	32
Kritikë ndaj kapitalizmit	15	27	24	16	2	1	85
Vlerëson linjën ideologjike të Partisë	25	45	62	68	42	34	276
Perspektiva e klasave (me theks luftën e klasave)	14	26	30	25	9	3	107
Vlerësohet trajtimi konceptit të njeriut të ri	14	27	38	24	13	9	125
Konformizmi vs integriteti krijues (ka nuanca tensioni, përpjekje për të balancuar midis konformizmit politik dhe ruajtjes së integritetit artistik)	0	0	6	18	23	33	80
Devijues nga këto korniza	0	0	6	23	25	29	83
Other	0	1	0	0	0	0	1
%							
Materializmi Dialektik	25.8%	30.6%	16.1%	11.3%	9.7%	6.5%	100.0%
Parimet e realizmit socialist si janë ndjekur	11.3%	19.2%	24.3%	15.8%	14.7%	14.7%	100.0%
Partia dhe roli i intelektualëve	12.1%	20.5%	22.0%	17.4%	13.6%	14.4%	100.0%
Emancipimi masës, roli i artit në transformimin e shoqërisë	7.0%	13.2%	16.9%	16.9%	22.6%	23.5%	100.0%
Lufta kundër kulturës borgjeze	15.6%	28.1%	28.1%	24.0%	3.1%	1.0%	100.0%
Kritika dhe autokritika	19.2%	20.5%	33.3%	9.0%	2.6%	15.4%	100.0%
Estetika e kolektivizmit	3.1%	0.0%	12.5%	43.8%	25.0%	15.6%	100.0%
Kritikë ndaj kapitalizmit	17.6%	31.8%	28.2%	18.8%	2.4%	1.2%	100.0%
Vlerëson linjën ideologjike të Partisë	9.1%	16.3%	22.5%	24.6%	15.2%	12.3%	100.0%
Perspektiva e klasave (me theks luftën e klasave)	13.1%	24.3%	28.0%	23.4%	8.4%	2.8%	100.0%
Vlerësohet trajtimi konceptit të njeriut të ri	11.2%	21.6%	30.4%	19.2%	10.4%	7.2%	100.0%
Konformizmi vs integriteti krijues (ka nuanca tensioni, përpjekje për të balancuar midis konformizmit politik dhe ruajtjes së integritetit artistik)	0.0%	0.0%	7.5%	22.5%	28.8%	41.3%	100.0%
Devijues nga këto korniza	0.0%	0.0%	7.2%	27.7%	30.1%	34.9%	100.0%
Other	0.0%	100.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	100.0%

Periudha 1966-1970: Frame-t mbizotërues të artikujve janë: Kritikë ndaj kapitalizmit 31.8%; Materializmi dialektik me 30.6%; Lufta kundër kulturës borgjeze 28.1%; Perspektiva e klasave (me theks luftën e klasave 24.3% ndërsa asnjë prej artikujve nuk i përket frame-t Estetika e kolektivizmit

Periudha 1971-1975: Frame-t mbizotërues të artikujve janë: Kritika dhe autokritika me 33.3%; Vlerësohet trajtimi i konceptit të Neriut të ri me 30.4%; Kritikë ndaj kapitalizmit 28.2%; Perspektiva e klasave (me theks luftën e klasave) 28%, Parimet e realizmit socialist si janë ndjekur 24.3 %, më i larti krahasuar me periudhat e tjera. Për herë të parë kemi shfaqjen e frameve ‘Konformizmi vs integriteti krijues’ dhe ‘Devijues nga këto korniza’ përkatësisht në vlerat 7.5% dhe 7.2%.

Periudha 1976-1980: Frame-t mbizotërues të artikujve janë: Estetika e kolektivizmit 43.8.8%; Vlerëson linjën ideologjike të Partisë me 24.6%, Lufta kundër kulturës borgjeze 24%; Perspektiva e klasave (me theks luftën e klasave 23.4%; Vlerësohet trajtimi i konceptit të njeriut të ri me 19.2% ndërsa vërehet një rënie e ‘Kritika dhe autokritika’ në vlerën 9% krahasuar me tre periudhat pararendese. Ndërkaq vërehet një rritje e madhe krahasuar me periudhat pararendese e artikujve klasifikuar në frame-t ‘Devijues nga këto korniza’ me 27.7% si dhe ‘Konformizmi vs integriteti krijues’ me 22.5%.

Periudha 1981-1985: Gjatë kësaj periudhe konstatohet një rritje e madhe krahasuar me periudhat pararendese e artikujve klasifikuar në frame-t ‘Devijues nga këto korniza’ me 30.1% si dhe ‘Konformizmi vs integriteti krijues’ me 28.8%. Frame të tjerë të artikujve me përqindje të lartë janë: Estetika e kolektivizmit 25%; Emancipimi i masës, roli i artit në transformimin e shoqërisë 22.6%; Vlerëson linjën ideologjike të Partisë 15.2%. Ndërkaq, ka një rënie në frame-t e artikujve: Kritikë kundër kapitalizmit në masën 2.4%, Luftë kundër kulturës borgjeze 3.1% si dhe Perspektiva e klasave (me theks luftën e klasave) 8.4%, të gjitha këto krahasuar me periudhat e mëparshme.

Periudha 1986-1990: Gjatë kësaj periudhe rezultojnë përqindja më e madhe e artikujve klasifikuar në frame-t ‘Konformizmi vs integriteti krijues’ me 41.3% si dhe ‘Devijues nga këto korniza’ me 34.9%. Frame të tjerë të artikujve me përqindje të lartë janë: Emancipimi i masës, roli i artit në transformimin e shoqërisë me 23.5%; Estetika e kolektivizmit 15.6%; Kritika dhe autokritika me 15.4%. Ndërkaq, përqindja më e ulët nga të gjitha periudhat historike vërehet në frame-t e artikujve: Luftë kundër kulturës borgjeze me 1.0 %; Kritikë ndaj kapitalizmit në masën 1.2 %, Perspektiva e klasave (me theks luftën e klasave) 2.8 %, Materializmi dialektik me 6.5%.

3.3 Gjuha në artikuj sipas periudhave historike

Periudha 1961-1965: Mbizotëron gjuha ‘Kritikë që konsideron parimet e estetikës së realizmit socialist’ me 9.9% dhe ‘Në linjë me ideologjinë e Partisë’ me vlerën 9.3%, ndërsa në asnjë prej artikujve të publikuar në këtë periudhë nuk konstatohet ‘Gjuhë që devijon nga kornizat’.

Periudha 1966-1970: Mbizotëron gjuha në linjë me ideologjinë e Partisë me vlerën 19%, ndërsa në asnjë prej artikujve të publikuar në këtë periudhë nuk konstatohet ‘gjuha mes konformizmit politik dhe përpjekjeve për të dalë jashtë kornizave, apo gjuhë që devijon nga kornizat.

Periudha 1971-1975: Mbizotëron gjuha në linjë me ideologjinë e Partisë me vlerën 26.6%, që është edhe vlera më e lartë krahasuar me periudhat e tjera historike. Si shpjegohet kjo, kur nga njëra anë kemi rritje të artikujve kritikë dhe gjithashtu për herë të parë në artikuj shfaqet ‘gjuha mes konformizmit politik dhe përpjekjeve për të dalë jashtë kornizave, në vlerën 15.4%? Një ndër arësyet mund të jetë rritja e autocensurës në këtë periudhë si rezultat i ndëshkimeve çka mund të reflektohet tek tonalitetet e gjuhës.

Periudha 1976 -1980: Mbizotëron gjuha celebruese në masën 28.7%, cka përfaqëson edhe vlerën më të lartë krahasuar me të gjitha periudhat e tjera historike ndërsa vërehet një rënie e gjuhës ‘Në linjë me ideologjinë e Partisë’ në vlerën 16.3% krahasuar me periudhën pararendëse. Ndërkaq, ‘Gjuha mes konformizmit politik dhe përpjekjeve për të dalë jashtë kornizave’ ka mbetur në të njëjtin nivel krahasuar me periudhën pararendëse, konkretisht në masën 15.4% ndërsa ‘gjuhë që devijon nga kornizat’ është rritur në vlerën 14.8%.

8. Tonalitetet e gjuhës sipas periudhave historike (Më shumë se një përgjigje)							
	1961-1965 (Plani i 3 pesëvjeçar)	1966-1970 (Plani i 4 pesëvjeçar)	1971-1975 (Plani i 5 pesëvjeçar)	1976 -1980 (Plani 6 pesëvjeçar)	1981-1985 (Plani i 7 pesëvjeçar)	1986-1990 (Plani i 8 pesëvjeçar)	Total
	Nr						
Celebruese	26	36	66	101	67	56	352
Kritikë që konsideron parimet e estetikës së realizmit socialist	16	21	29	25	30	41	162
Në linjë me ideologjinë e PPSH	27	55	77	47	43	40	289
Gjuhë që devijon nga kornizat	0	0	6	9	24	22	61
Gjuhë midis konformizmit politik vs përpjekje për të dal jashtë kornizave	1	0	8	8	10	25	52
	%						
Celebruese	7.4%	10.2%	18.8%	28.7%	19.0%	15.9%	100.0%
Kritikë që konsideron parimet e estetikës së realizmit socialist	9.9%	13.0%	17.9%	15.4%	18.5%	25.3%	100.0%
Në linjë me ideologjinë e PPSH	9.3%	19.0%	26.6%	16.3%	14.9%	13.8%	100.0%
Gjuhë që devijon nga kornizat	0.0%	0.0%	9.8%	14.8%	39.3%	36.1%	100.0%
Gjuhë midis konformizmit politik vs përpjekje për të dal jashtë kornizave	1.9%	0.0%	15.4%	15.4%	19.2%	48.1%	100.0%

Periudha 1981-1985: Mbizotëron ‘Gjuhë që devijon nga kornizat’ në masën 39.3%, më e larta krahasuar me të gjitha periudhat e tjera të marra në studim. Edhe ‘Gjuha mes konformizmit politik dhe përpjekjeve për të dalë jashtë kornizave’ është rritur krahasuar me periudhën pararendëse duke kapur shifrën 19.2%. Në këtë periudhë thellohet më tej trendi në rënie i gjuhës ‘Në linjë me ideologjinë e Partisë’ në vlerën 14.9% si dhe gjuhës ‘Celebruese’ në vlerën 19% krahasuar me periudhën pararendëse.

Periudha 1986-1990: Mbizotëron ‘Gjuha mes konformizmit politik dhe përpjekjeve për të dalë jashtë kornizave’ me 48.1%, cka përfaqëson dhe përqindjen më të lartë krahasuar me të gjitha periudhat e tjera historike. Gjithashtun në artikujt e kësaj periudhe vërehet një përqindje e lartë e ‘Gjuhë që devijon nga kornizat’ në masën 36.1%. Në këtë periudhë thellohet më tej trendi në rënie i gjuhës ‘Në linjë me ideologjinë e Partisë’ në vlerën 13.8% si dhe gjuhës ‘Celebruese’ në vlerën 15.9% krahasuar me periudhën pararendëse.

3.4. Toni i artikujve sipas periudhave historike

Periudha 1961-1965: Nga totali i artikujve me ton negativ, 10% i përkasin kësaj periudhe ndërsa 9.4% e artikujve janë me ton devijues.

Periudha 1966 – 1970: në këtë periudhë nuk ka shumë dallime përsa i përket artikujve me ton pozitiv e negativ, të cilët janë përkatësisht në vlerat 12% dhe 10% krahasuar me periudhat e tjera historike.

Periudha 1971 -1975: Në këtë periudhë rezulton përqindja më e lartë e artikujve me ton neutral 46.5% dhe negativ me 40% krahasuar me periudhat e tjera historike.

Periudha 1976 - 1980: Në këtë periudhë mbizotëron toni pozitiv i artikujve në masën 25.2%, çka përfaqëson edhe periudhën me përqindjen më të lartë të artikujve me ton pozitiv krahasuar me periudhat e tjera historike. Një fakt tjetër interesant është se në këtë periudhë nuk hasen artikuj me ton negative ndërsa 8.1% e artikujve kanë ton neutral.

Periudha 1981 – 1985: në këtë periudhë vërehet rritje e tonit ‘Devijues’ në artikuj e shprehur në vlerën 21.9% krahasuar me periudhën paraardhëse që ishte 3.1% e totalit. Specifikë e kësaj periudhe është mungesa e tonit ‘Negativ’ në artikuj ndërsa toni ‘Pozitiv’ është prezent në masën 21.2%. Ndërkaq, 23.3% e artikujve kanë ton ‘Neutral’ çka përfaqëson edhe periudhën me përqindjen më të lartë të artikujve me ton neutral krahasuar me periudhat e tjera historike.

11. TONI I ARTIKUJVE SIPAS PERIUDHAVE HISTORIKE							
	1961-1965 (Plani i 3 pesëvjeçar)	1966-1970 (Plani i 4 pesëvjeçar)	1971-1975 (Plani i 5 pesëvjeçar)	1976-1980 (Plani 6 pesëvjeçar)	1981-1985 (Plani i 7 pesëvjeçar)	1986-1990 (Plani i 8 pesëvjeçar)	Total
	Nr						
Devijues	3	0	7	1	7	14	32
Negativ	1	1	4	0	0	4	10
Neutral	3	2	40	7	20	14	86
Pozitiv	26	54	68	113	95	93	449
	%						
Devijues	9.4%	0.0%	21.9%	3.1%	21.9%	43.8%	100.0%
Negativ	10.0%	10.0%	40.0%	0.0%	0.0%	40.0%	100.0%
Neutral	3.5%	2.3%	46.5%	8.1%	23.3%	16.3%	100.0%
Pozitiv	5.8%	12.0%	15.1%	25.2%	21.2%	20.7%	100.0%

Periudha 1986 -1990: në këtë periudhë rezulton përqindja më e madhe e tonit ‘Devijues’ në artikuj e shprehur në vlerën 43.8% nga të gjitha periudhat historike të marra në studim. Specifikë e kësaj periudhe është përqindja e lartë e artikujve me ton ‘Negativ’ në masën 40%. Ndërkaq, vërehet rënie e përqindjes së artikujve me ton ‘Neutral’ e ‘Pozitiv’ krahasuar me periudhën paraardhëse, secila përkatësisht 16.3% dhe 20.7%.

3.5 Togfjalëshat kyç

Nga 27 togfjalëshat kyç të identifikuar për nevojat e studimit, rezulton se togfjalëshi më i përdorur në gjithë harkun kohor 30 vjeçar është ‘Vija e Partisë’, me frekuencën më të lartë të pasqyrimin në artikuj 35 herë me frekuencë mbi 10 herë, 61 herë me frekuencë 5-10 herë si dhe 224 herë me frekuencë deri në 3 herë. Togfjalëshat e tjerë më të përdorur sipas frekuencave përkatëse janë: ‘Forcimi i përmbajtjes ideo-artistike’; Fryme revolucionare; shoqeri e re socialiste; masat punetore; Fryma kombetare; Njeriu i ri; Realizmi socialist; Edukimi i rinise socialiste, si dhe Lufta e klasave.

Ndërkaq, togfjalëshi me frekuencën më të ulët të përmbajtjes në artikuj është ‘Fryma burokratike’ i cili shfaqet 41 herë me frekuencë deri 3 herë, 9 herë me frekuencë 5-10 herë si dhe asnjë herë me frekuencë mbi 10 herë. Ky togfjalësh pasohet nga togfjalëshat e tjerë të renditur sipas frekuencës më të ulët, konkretisht: ‘Mendime mikroborgjeze, indiferentizmi’; ‘Fshatarësia kooperativiste’; ‘armiqtë e brendshëm’; ‘Morali komunist’; ‘Ideologji reaksionare’; ‘Dialektika materialiste’; ‘Heroi pozitiv’; ‘Shfaqje te huaja’ si dhe ‘Art revolucionar’.

3.6 Konstruktet ideologjike sipas periudhave historike

Periudha 1961-1965: Konstruktet ideologjike mbizotëruese në këtë periudhë krahasuar me periudhat e tjera historike janë: ‘Tabani popullor dhe kombëtar varësisht temës’ me 20.3%; Lufta kundër shfaqjeve të huaja me 18.1%; Kritik nisur nga fryma revolucionare dhe patriotike varësisht temës me 15.7%. Asnjë prej artikujve nuk i përket konstruktit ideologjik ‘Devijues nga konstruktet ideologjik’ ndërsa ‘Konformizëm vs integritet i krijuesit’ është i ulët në vlerën 1.2%.

Periudha 1966 – 1970: konstruktet ideologjike mbizotëruese në këtë periudhë krahasuar me periudhat e tjera historike janë: Tabani popullor dhe kombëtar varësisht temës me 26.1%; Njeriu i ri me 24.5%; Kritik nisur nga fryma revolucionare dhe patriotike varësisht temës me 23.5%, Lufta kundër shfaqjeve të huaja me 21%. Asnjë prej artikujve nuk i përket konstrukteve ideologjike ‘Konformizëm vs integritet i krijuesit dhe ‘Devijues nga konstruktet ideologjik’.

Periudha 1971- 1975: konstruktet ideologjike mbizotëruese në këtë periudhë krahasuar me periudhat e tjera historike janë: Lufta kundër shfaqjeve të huaja me 26.7%, Njeriu i ri me 26.5%, Kritik nisur nga fryma revolucionare dhe patriotike varësisht temës me 22.5%, Si vjen vepra në metodën e realizmit socialist me 21.8%. Gjithashtu, për herë të parë shfaqen edhe konstruktet ideologjike ‘Konformizëm vs integritet i krijuesit dhe ‘Devijues nga konstruktet ideologjik’ përkatësisht në masën 9.4% dhe 8.2%

12. Konstruktet ideologjik në artikull sipas periudhave historike (Më shumë se një përgjigje)							
	1961-1965 (Plani i 3 pesëvjeçar)	1966-1970 (Plani i 4 pesëvjeçar)	1971-1975 (Plani i 5 pesëvjeçar)	1976-1980 (Plani 6 pesëvjeçar)	1981-1985 (Plani i 7 pesëvjeçar)	1986-1990 (Plani i 8 pesëvjeçar)	Total
	Nr						
Besnik ndaj vijës së PPSH në trajtimin e kritikës	25	49	66	60	55	51	306
Se si vjen vepra në metodën e Realizmit Socialist	22	33	45	33	38	35	206
Kritik nisur nga fryma patriotike dhe revolucionare varësisht temës	16	24	23	24	11	4	102
Tabani popullor dhe kombëtar varësisht temës	14	18	13	18	5	1	69
Lufta e lavdishme Nacionalçlirimtare (opozitarët armiq)	11	19	23	45	6	2	106
Njeriu i Ri	16	37	40	34	13	11	151
Lufta kundër armikut të klasës	17	24	26	34	13	4	118
Lufta kundër shfaqjeve të huaja	19	22	28	24	9	3	105
Parimet estetike të Marksizëm- Leninizmit	18	27	29	31	15	19	139
Devijues nga konstruktet ideologjik	0	0	7	15	34	29	85
Konformizëm vs integritet i kritikut	1	0	8	16	23	37	85
	%						
Besnik ndaj vijës së PPSH në trajtimin e kritikës	8.2%	16.0%	21.6%	19.6%	18.0%	16.7%	100.0%
Se si vjen vepra në metodën e Realizmit Socialist	10.7%	16.0%	21.8%	16.0%	18.4%	17.0%	100.0%
Kritik nisur nga fryma patriotike dhe revolucionare varësisht temës	15.7%	23.5%	22.5%	23.5%	10.8%	3.9%	100.0%
Tabani popullor dhe kombëtar varësisht temës	20.3%	26.1%	18.8%	26.1%	7.2%	1.4%	100.0%
Lufta e lavdishme Nacionalçlirimtare (opozitarët armiq)	10.4%	17.9%	21.7%	42.5%	5.7%	1.9%	100.0%
Njeriu i Ri	10.6%	24.5%	26.5%	22.5%	8.6%	7.3%	100.0%
Lufta kundër armikut të klasës	14.4%	20.3%	22.0%	28.8%	11.0%	3.4%	100.0%
Lufta kundër shfaqjeve të huaja	18.1%	21.0%	26.7%	22.9%	8.6%	2.9%	100.0%
Parimet estetike të Marksizëm- Leninizmit	12.9%	19.4%	20.9%	22.3%	10.8%	13.7%	100.0%
Devijues nga konstruktet ideologjik	0.0%	0.0%	8.2%	17.6%	40.0%	34.1%	100.0%
Konformizëm vs integritet i kritikut	1.2%	0.0%	9.4%	18.8%	27.1%	43.5%	100.0%

Periudha 1976 -1980: Konstruktet ideologjike mbizotëruese në këtë periudhë krahasuar me periudhat e tjera historike janë: Lufta e lavdishme Nacional-çlirimtare në masën 42.5%, Lufta kundër armikut të klasës me 28.8%; Kritik nisur nga fryma revolucionare dhe patriotike varësisht temës me 23.5%, Lufta kundër shfaqjeve të huaja me 22.9%, Parimet estetike të Marksizëm-leninizmit me 22.3%. Ndërkaq konstatohet një rritje e artikujve që i përkasin konstrakteve ideologjike ‘Konformizëm vs integritet i krijuesit’ me vlerën 18.8% (dyfishim krahasuar me periudhën pararendëse) dhe ‘Devijues nga konstruktet ideologjik’ me 17.6%.

Periudha 1981-1985: konstruktet ideologjike mbizotëruese në këtë periudhë krahasuar me periudhat e tjera historike janë: ‘Devijues nga konstruktet ideologjik’ me 40 % si dhe ‘Konformizëm vs integritet i krijuesit’ me vlerën 27.1%. ‘Lufta e lavdishme Nacional-çlirimtare’ është në masën 5.7% cka tregon një rënie të madhe krahasuar me periudhën paraardhëse që ishte

42.5% sikurse edhe 'Tabani popullor dhe kombëtar varësisht temës' me 7.2%; 'Lufta kundër shfaqjeve të huaja' me 8.6%; 'Parimet estetike të Marksizëm-leninizmit' me 10.8%. Konstruktet ideologjike që thuajse ruajnë të njëjtat vlera me fare pak diferenca gjatë periudhave historike janë: 'Besnik ndaj vijës së PPSH-së në trajtimin e kritikës' me 18% si dhe 'Se si vjen vepra me metodën e realizmit socialist' me 18.4% të totalit të artikujve.

Periudha 1986-1990: konstruktet ideologjike mbizotëruese në këtë periudhë krahasuar me periudhat e tjera historike janë: 'Konformizëm vs integritet i krijuesit' me vlerën 43.5% si dhe 'Devijues nga konstruktet ideologjik' me 40 %. Ndërkaq, krahasuar me periudhën paraardhëse vërehet një rënie e artikujve që i përkasin konstrakteve ideologjike përkatësisht: 'Tabani popullor dhe kombëtar varësisht temës' me 1.4%; 'Lufta e lavdishme Nacional-clirimtare' në masën 1.9 %; 'Lufta kundër shfaqjeve të huaja' me 2.9%; 'Lufta kundër armikut të klasës' me 3.4%; 'Kritik nisur nga fryma patriotike e revolucionare varësisht temës' me 3.9%.

3.7 Gjetje cilësore

Roli dhe detyrat e kinematografisë dhe kritikës sipas artikujve. Evoluimi nga 1961-1990

1962: Roli i kinematografisë për edukimin e masave: *'Kinematografia jonë ka nevojë për skenarë t'atillë që të kthyer në filma, do të shërbejnë për edukimin revolucionar të masave tona punonjëse. Ato duhet të karakterizohen nga një frymë e lartë Partie, nga ideologjia revolucionare e Marksizëm-Leninizmit. Ato duhet të rrisin patriotizmin e masave, të zhvillojnë ndjenjën e internacionalizmit proletar, të rrisin shpirtin e tyre revolucionar, optimizmin e tyre socialist dhe t'i mobilizojnë ato më gjerësisht në ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste dhe në mbrojtjen e pamvarësisë sonë kombëtare. Filmat t'anë duhet të përshkohen nga paraqitja e realitetit tonë në zhvillimin e tij revolucionar, pra nga paraqitja e luftës plot vetmohim dhe të sukseseve të masave punonjëse, nën udhëheqjen e Partisë, për ndërtimin e shoqërisë socialiste, nga paraqitja në mënyrë artistike e transformimeve të thella ideologjike e shpirtërore që ndodhin tek ne, në procesin e vrullshëm të krijimit të njeriut të ri dhe shoqërisë së re.*

Në filmat artistikë kërkohet të trajtohen tema aktuale, *'të trajtohen probleme lidhur me luftën e popullit tonë për ndërtimin e jetës së re, luftën e partisë për edukimin e njerëzve me ndërgjegje socialiste, të trajtohen probleme shoqërore nga lufta e përditshme në mes të së resë dhe të vjetrës, tema që rritin patriotizmin socialist të masave'.*

Periudha 1961-1965 përkon me ashpërsimin e luftës midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit. Në shtypin e kohës pesëvjecari i 3-të konsiderohet si pesëvjecari i luftës kundër bllokadës imperialiste-revizioniste edhe në frontin e kulturës dhe artit: *'lufta e ashpër ideologjike që zhvillohet sot midis socializmit dhe imperializmit si dhe midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit ka gjetur shprehjen e saj dhe në fushën e artit kinematografik, i cili sic dihet zë një vend të rëndësishëm në frontin ideologjik'.*



1964: Në artikullin kritik mbi filmin ‘Toka jonë’ krahas disa aspekteve teknike si varfëria e botës së personazheve, filmi i fragmentuar, etj., shprehet shqetësimi se filmi nuk ishte realizuar mirë nga pikëpamja politike, nuk ishte thelluar sa duhej në rrethanat e transformimeve të mëdha që sollli pushteti i popullit dhe reforma agrare më 1946 pasi *‘ne nuk shohim në fytyrat e fshatarëve se po ndodh diçka e jashtëzakonshme dhe pikërisht ajo që do të shkaktonte dramën për të cilën është bërë filmi’*.

1965: Roli dhe detyra e kritikës: *‘kemi nevojë për një kritikë thellësisht parimore e të partishme, për një kritikë që të mbrojë me vendosmëri parimet marksiste-leniniste në fushën e artit e të letërsisë, që të goditë çdo shfaqje të huaj për ideologjinë dhe moralin tonë, që të përkrahë e të mbështetë atë që është e shëndoshë, revolucionare, atë që militon për vijën e partisë e që shërben për edukimin komunist të masave. Kritika jonë duhet të demaskojë pikëpamjet revizioniste në art dhe të zbulojë falsitetin, kalbëzimin dhe rrezikun e tyre’*.

Shtypit letrar, specifikisht gazeta Drita duhej të luftonte *‘për të ngritur rolin dhe rëndësinë e kritikës, principialitetin dhe vërtetësinë e saj, të preokupohej për rritjen e më shumë kuadrove të reja të kritikëve, për zhvillimin e estetikës marksiste, për orientimin e drejtë të kritikës.’*

1966: Në faqen e parë të gazetës Drita botohen pjesë nga raporti i Enver Hoxhës, mbajtur në Kongresin e 5-të të PPSH-së, ku parashtrihen kërkesat ndaj letërsisë dhe artit: *‘Partia shtron*

detyrën që letërsia dhe artet të bëhen një armë e fuqishme në duart e partisë për edukimin e punonjësve në frymën e socializmit e të komunizmit; që ato të qëndrojnë në rradhët e para të luftës për të edukuar një rini të pastër ideologjikisht e moralisht; që gjithë krijimtaria artistike të ketë një nivel të lartë ideologjik, të përshkohet nga fryma revolucionare luftarake e partisë si dhe nga një frymë e shëndoshë kombëtare. Partia kërkon që letërsia dhe artet të pasqyrojnë më gjërë luftën, punën dhe jetën e popullit punonjës, idealet dhe aspiratat e tij, ndjenjat e tij fisnike, karakterin e tij heroik, thjeshtësinë dhe madhështinë e tij, hovin e tij revolucionar, të pasqyrojnë me vërtetësi dhe në zhvillimin e vet revolucionar realitetin dhe aktualitetin tonë, që në qendër të krijimtarisë të vihen heronjë e kohës sonë -punëtorët, fshatarët, ushtarët, intelektualët popullorë dhe kuadrot revolucionare, njerëzit e rinj të edukuar nga partia, ata që me vetëmohim e heroizëm punojnë e luftojnë për ndërtimin e socializmit, për mbrojtjen e lulëzimin e Atdheut socialist; që institucionet artistike dhe kulture të udhëhiqen kurdoherë nga kërkesat ideologjike të partisë, të luftojnë e të demaskojnë ideologjinë borgjeze, me qëllim që të ushtrojnë në masat një ndikim edukativo-revolucionar, të jenë të popullit dhe për popullin’.

1969: Kongresi II i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve: theksohet se në thelb të letërsisë dhe arteve kanë qenë dhe mbeten vija dhe ideologjia marksiste-leniniste e partisë, pjesëmarrja aktive në luftën për ndërtimin e socializmit. *‘Nga letërsia dhe arti kërkohet që të vihen në rradhët e para të luftës së masave punonjëse për thellimin e pandërprerë të revolucionit socialist, të luajnë edhe më mirë rolin e tyre mobilizues e edukues të masave’.*

1970: Zbatimi i partishmërisë në veprat letrare e artistike: Në artikullin e botuar në prill të vitit 1970 titulluar ‘Lenini dhe partishmëria proletare në art’ theksohej se *‘çdo vepër letrare dhe artistike duhet të analizohet sipas proverbës latine: cui prodest- kush përfiton nga kjo – se shkrimtarët dhe artistët nuk mund të jenë ‘sipërnjerëzorë’, se asnjë nuk mund të krijojë e predikojë jashtë interesave klasore. Lenini kërkonte që arti dhe letërsia e re socialiste, të cilat sa po lindnin në fillim të këtij shekulli, të kishin në themel të tyre partishmërinë proletare’.*

DRITA

ORGAN I NDËRHES SE SHKRYMTARËVE DHE ARTISTEVË TË REPUBLIKËS



V. I. LENIN DHE PARTISHMERIA PROLETARE NE ART

Lenin është një nga ditët më të shquara për gjithë popullin e botës, sepse në këtë ditë lindi njëri nga emërtin e të cilin është lidhur shpirti e 20 në zhvillimin e marksizmit, epoka e re historike, epoka e revolucioneve proletare, e lirisjes së lirimit të shtypura dhe të shpërndarjes kundër sundimit të kapitalit, epoka e kthimit nga kapitalizmi në socializëm dhe në komunistë.

Dita e 27 prillit është një nga ditët më të shquara për gjithë popullin e botës, sepse në këtë ditë lindi njëri nga emërtin e të cilin është lidhur shpirti e 20 në zhvillimin e marksizmit, epoka e re historike, epoka e revolucioneve proletare, e lirisjes së lirimit të shtypura dhe të shpërndarjes kundër sundimit të kapitalit, epoka e kthimit nga kapitalizmi në socializëm dhe në komunistë.

ENVER HOXHA

SESION SHKENCOR KUSHTUAR 100-VJETORIT TE DITELINDJES SE V. I. LENINIT

Shekulli i shtatë përmirësi dhe shpirtëri... K. PRASHI... VITI X, Nr. 16, 1971... 19 PRILL 1970... Çmimi 30 qindarka



Zëri i historisë

T... (Text continues with historical context and analysis of the exhibition and the political climate of the time.)



Ekspozitë për 100-vjetorin e ditëlindjes së V. I. Leninit

Ekspozitë për 100-vjetorin e ditëlindjes së V. I. Leninit... (Text describes the exhibition and its significance.)

Vitet '71, '72 patën një farë lirie artistike gjë që reflektohet edhe në shtimin e artikujve kritikë mbi letërsinë dhe artin, rrjedhimisht edhe mbi kritikën e filmit. Ndërsa në dokumentet zyrtare kërkohej revolucionarizimi i mëtejshëm i letërsisë dhe artit, në faqet e gazetës publikohen një seri artikujsh që trajtojnë kritikën e filmit shqiptar ku ka përplasje idesh, qëndrimesh, etj. Duke e konsideruar filmin si një mjet që ndihmon për edukimin ideologjik të masave, theksi në kritikë vihej në forcimin ideo-estetik.

1971: Regjizori M. Luarasi evidenton mungesën e kritikës profesionale të filmit teksa shigjetonte regjizorë, skenaristë e operatorë të njohur se nuk po e kryenin edhe rolin që u takon si kritikë dhe estetë të artit të tyre. Luarasi shprehej se nuk kishte kritikë kinematografike në kuptimin e plotë të fjalës. Sipas tij 'Shkrimet që botohen në gazeta e revista nga shokë të zellshëm e që i ha merakun për filmin janë vetëm recensione me një farë dobie, por ato nuk prekin thelbin ideor dhe estetik të këtij arti. Më shumë janë përshkrues të ngjarjeve të filmit, cekin aty këtu ndonjë gjë që ka të bëjë me përmbajtjen apo me vërtetësinë e ndonjë episodi të krahasuar me jetën dhe asgjë më. Bile ka raste kur të përfshirë nga entuzasmi e dashamirësia apo thjesht nga shijet subjektive

të pabazuara e të paargumentuara, recenzentët kënaqen me gjithëshka e gjejnë epitete të bukur e tingëllues edhe për atë që është mediokre e nuk thotë asgjë të re. Mirëpo kështu ka rrezik ta ngrejme mediokritetin në pedestal. Sepse nga një atmosferë vetëkënaqësie nuk del asgjë tjetër vec mediokritetit. Ata që shkruajnë për filmin, me përjashtime të rralla kur autori është i zanatit, nuk e njohin specifikën e artit kinematografik, mjetet e tij shprehëse, gjuhën e tij, prandaj edhe nuk flasin për to por e trajtojnë filmin sikur të ish letërsi, teatër, apo mësim historii'. Luarasi i mëshonte idesë se duhet të jenë vetë punonjësit e filmit regjizorët, skenaristët, operatorët, etj., që duhet të bëjnë kritikën e filmit ndërsa 'aktivizimi që i bëhet nga shtypi opinionit të masave për filmin me anë të shkrimeve nga spektatorët apo me anë të letrave, përshtypjeve e formave të tjera është i nevojshëm dhe shumë i dobishëm, por kurrsesi nuk e zëvendëson dhe nuk përbën kritikën profesionale, thellësisht parimore e me kërkesa të larta ideoartistike'.

Luarasi ishte kritik ndaj problematikave me të cilat përballej filmi shqiptar. Sipas tij 'Kinematografia ka probleme dhe këto probleme nuk mund të mbeten një punë e 'brëndshme' e kinostudios, hermetikisht të mbyllura...rezervohen regjizorët e skenaristët të shkruajnë kritika serioze, të thelluara për krijimet e shokëve të tyre apo artikuj problemorë. Cilatdo qofshin arësyet që i bëjnë të mos i shprehin në shtyp mendimet kineastët tanë, një gjë mbetet e vërtetë: heshtja e tyre nuk është e mirë. Ndërkohë filmat nuk po i nënshtrohen kritikës profesionale. Qofsha i gabuar, por më duket se tek disa ekziston një lloj frike nga kritika, i flladit kënaqësia që s'ka kritikë kinematografike ...Ideologjikisht kineastët tanë rrugën e kanë të qartë dhe e kanë pasur të qartë gjithnjë. Fjala është në perfeksionimin e mëtejshëm të mjeteve artistike dhe të teknikës kinematografike, për një njohje më të gjerë e më serioze të rezultateve, që bota i ka arritur, për një shfrytëzim me mend të tyre nga ne. Është një fakt i pranuar se, me gjithë filmat e mirë që kemi bërë, teknikisht jemi prapa'.



Drita

ORGANI I LIDHJES SË SHKRIKIMARËVE DHE ARTISTEVËR TË SHQIPËRISË

Partishmëria komuniste - parim i madh i letërsisë dhe arteve tona

Pleniumi IV i KQ të PPSH, që u mbajt në ditët e 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 të muajit shtator të vitit 1974, është një nga momentet më të rëndësishme të historisë së popullit tonë. Në këtë plenium, u diskutuan dhe u vendosën çështjet më të rëndësishme të shtetit tonë demokratik dhe të bashkëpunimit me bashkëkombësit e vendeve të tjera. Pleniumi u hap në ditën e 17 shtatorit, në ora të mërkurës, në sallën e Kulturës së Popullit të Qytetit të Tiranës. Në këtë plenium, u diskutuan dhe u vendosën çështjet më të rëndësishme të shtetit tonë demokratik dhe të bashkëpunimit me bashkëkombësit e vendeve të tjera. Pleniumi u hap në ditën e 17 shtatorit, në ora të mërkurës, në sallën e Kulturës së Popullit të Qytetit të Tiranës.

Karakteristikë e kësaj mbledhjeje është fakti që për herë të parë në historinë e shtetit tonë demokratik, u diskutuan dhe u vendosën çështjet më të rëndësishme të shtetit tonë demokratik dhe të bashkëpunimit me bashkëkombësit e vendeve të tjera. Pleniumi u hap në ditën e 17 shtatorit, në ora të mërkurës, në sallën e Kulturës së Popullit të Qytetit të Tiranës. Në këtë plenium, u diskutuan dhe u vendosën çështjet më të rëndësishme të shtetit tonë demokratik dhe të bashkëpunimit me bashkëkombësit e vendeve të tjera.

Partia dhe shteti tonë demokratik, që për herë të parë në historinë e shtetit tonë demokratik, u diskutuan dhe u vendosën çështjet më të rëndësishme të shtetit tonë demokratik dhe të bashkëpunimit me bashkëkombësit e vendeve të tjera. Pleniumi u hap në ditën e 17 shtatorit, në ora të mërkurës, në sallën e Kulturës së Popullit të Qytetit të Tiranës.

Një vlerë e rëndësishme e kësaj mbledhjeje është fakti që për herë të parë në historinë e shtetit tonë demokratik, u diskutuan dhe u vendosën çështjet më të rëndësishme të shtetit tonë demokratik dhe të bashkëpunimit me bashkëkombësit e vendeve të tjera.

Jehona e Pleniumit të IV të KQ të PPSH-së dhe fjalimi i E. Hoxhës më 20 dhjetor 1974 do të shfaqej për afro një dekadë në artikujt e botuar në gazetë, tematikat e filmit, ku theksi do të vihej tek thellimi i luftës ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, heroi pozitiv, forcimi i parimit të partishmërisë dhe botëkuptimit marksist-leninist, edukimi ideestetik i masave punonjëse, edukimi i Njeriut të ri me botëkuptimin marksist-leninist, me normat e moralit komunist; lufta kundër burokratizmit, etj. Në faqen e parë të gazetës botohen slogane e citate të shkëputura nga fjalimi i E. Hoxhës mbajtur në Pleniumin e IV të Partisë madje fjalimi i Hoxhës mbajtur në dhjetor 74 do të perkujtohet si ngjarje e rëndësishme per artin e kulturen.

'Partia duhet të krijojë në njerëzit dhe në shoqëri atë botëkuptim, ato zakone, ato ndjenja, ato shije, atë etikë, atë filozofi revolucionare që të mos lejojë pikërisht as ringjalljen e as përhapjen e botëkuptimeve mikroborgjeze e borgjeze'

Nga viti 1976 deri në fillimin e viteve '80 kërkohet që krijimtaria letraro-artistike të shihet në prizmin e luftës së klasave si dhe thellimi i karakterit kombëtar në filmin artistik.

1976: Arti tek ne u përmbahet idealeve të socializmit

'Shteti', thuhet në Projektkushtetutën e re, neni 35, përkrah zhvillimin e letërsisë dhe të artit sipas metodës së realizmit socialist. Letërsia dhe arti u përmbahen idealeve të socializmit e të komunizmit dhe përshkohen nga fryma kombëtare e popullore'.

1976: Formimi ideo-artistik -kusht i domosdoshëm për krijimtari artistike të shëndoshë

'lufta klasore në fushën e artit e të mendimit estetik është bërë shumë më e mprehtë. Kjo luftë që zhvillohet në shkallë të përbotshme, nuk mund të mos shprehet edhe në letërsinë, në artet dhe në mendimin tonë estetik e kritik...Shkrimtarët dhe artistët, si punonjës të frontit ideologjik, nuk mund ta kryejnë si duhet detyrën e tyre pa njohur në themel bazat e botëkuptimit marksist-leninist, në lidhje të ngushtë me orientimet e PPSH dhe me praktikën revolucionare të ndërtimit të socializmit në vendin tonë'.



1984 Kongresi i tretë i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve: theksohet nevoja që vlerat artistike të jenë kriteri bazë për vlerësimin dhe dhënien e çmimeve veprave të artit; ndryshon qëndrimi ndaj artit botëror dhe theksohet nevoja për të përfituar prej tij.

Në vitet '86 - '90 (pas vdekjes së diktatorit E. Hoxha) mbizotërojnë përpjekjet për originalitet në krijimtari. Ishin një sërë faktorësh të karakterit politik kryesisht që krijuan kushtet për disa ndryshime cilësore në fushën e artit. Shkëmbimet dhe pjesëmarrjet në evente ndërkombëtare të

filmit, përfshirë vendet perëndimore u zgjeruan ndjeshëm. Ndonëse të pakët në numër, kineastë të rinj u dërguan për specializime në Francë, Itali, Danimarkë, etj. Prandaj, jo rastësisht kjo periudhë përfaqëson edhe numrin më të madh të artikujve kritikë mbi çështjet e filmit. Fryma liberale dhe era e ndryshimeve shfaqet si në tonalitetet e gjuhës së artikujve ku mbizotëron ‘Gjuha mes konformizmit politik dhe përpjekjeve për të dalë jashtë kornizave’ dhe ‘Gjuha që devijon nga kornizat’.

1988: Art novator për një shoqëri novatore



Drita

E PËRJAVNIME LETRARE ARTISTIKE - ORGAN I LIDHJES SË SHKREJTARËVE DHE ARTISTËVE TË SH

Art novator për një shoqëri novatore

Ata që kanë dashur të njohin a të diskreditojnë metodën e realizmit socialist, teoricienët e estetikës borgjeze e revizionistë, e kanë përçulluar dhe e paragonin atë me njërin prej tipareve më thelbësore të saj, pa novatorizmin. Por një letërsi pa novatorizëm mund të jetë gjithçka, veç krijimtari ja. Eshët i qartë synimi i këtyre teoricienëve: duke e cilësuar artin e realizmit socialist si një art të mbushur me shablone, ata duan ta shpallin vetë metodën e tij si një shpallje nga rruga e zhvillimit të natyreshëm të krijimtarisë njerëzore. Siç kuptohet, filijimi që kërkohet nuk është i vogël!

Praktika letrare në vendin tonë, siç theksoi shoku Ramiz Alia në Plenumin e 5-të, i ka sfiduar këto anatoma të helmeza, duke provuar se metoda e realizmit socialist ka në thelbin e vet jo ngurtësinë, por novatorizmin, jo skematizmin, por pasurinë jetësore, jo unifikimin e stiveve dhe rralshimin e individualiteteve, por larosinë dhe origjinalitetin e tyre. Kjo duket qartë sidomos në arrijtet më me vlerë të letërsisë e të arteve tona të kohës së Pa-

rtisë.

Novatorizmi e përmban në thelbin e saj vetë jeta jonë. Në Shqipëri çdo gjë është e re. Në vitalitet të pashtershëm është vendi ynë shoqëror socialist. Përbërë i frenakët është pushteti i popullit, gjithnjë aktivë është demokracia e masave. E re është punja e transformuar e vendit; që nga bregdeti në malësi. Në rinim të përhershëm është vetë populli ynë; mosha mesatare e të cilët është vetëm 26 vjeç. Të reja janë konceptet e njerëzve për jetën, mënyra e jetesës dhe kuptimi i tyre mbi botën. Një shoqëri e tillë novatore ka nevojë për një art revolucionar të çliruar nga skema dhe uniformiteti.

Sot, në ditën e novatorëve; nderohet e nderohet lart me shumë se kurdoherë krijimtaria njerëzore, jo vetëm në arte, por dhe në prodhim, në shkencë, në teknikë e në teknologji, në drejtim e në organizim. Afërsisht krijues të popullit në socializëm shumëfishohen, talentet e tij shprehen lirisht në vepra të spikatura. Në një kuptim të tillë të gjerë, 11 shtatori

është festa e krijimtarisë në përgjithësi, jo vetëm e novatorëve dhe racionalistëve të prodhimit.

Shkrimtarët dhe artistët vijojnë në këtë ditë me ndjenjë më të madhe detyrimi ndaj popullit, të vetdijshëm që novatorizmi të masave në punën ndërtuese, është (!) përgjegjës me vepra të cilësisë së lartë, origjinale në formë e në përmbajtje, novatorë në tematikë e në trajtim, Artistët është mendimtar, është qytetar militant, që i jeton me intensitet zhvillimet në shoqëri. Ai është vashdimshëm në kërkim për të zbuluar aspekte të reja të veprimtarisë shoqërore, për të gjetur mundësi të tjera shprehëse. Dhe kërkimi lind të rene, novatoren, të papriturës, befasimin, lind artin e vërtetë, që i qëndron kohës dhe i mbetet trashëgim thesarit të vlerave shpirtërore të popullit.

Novatorja në letërsi e në art është e lidhur organikisht me lulëzimin e individualiteteve. Dhe individualitetin nuk e siguron thjesht vënia e emrit të autorit pranë titullit të librit, e nënshkrimit të piktorit në fund të tablosë apo e firmës së regjisorit në titrat e veprës filmike. Individualitetin e tregon vepra. Nuk mund të ketë art novator në ato krijime që luajtojnë nga të tjerët problematikën dhe mjetet letrare, frymën

(vijon në f. 4)

Kinematografia dhe mekanizmi i ri ekonomik

Fo bëhet afro një vit që nga vendimet e Komitetit të shtetit të KQ të PPSH me të cilat filluan në Kinostudio shtetërore të vashdeshura për gjetjen e rrugëve më efektive të prodhimit kinematografik, për ta bërë atë më rentabilë e për të arritur në radhë të parë nivelin e tij cilësor. Nga të gjithë artet, kinematografia është më komplekse e më problematike e vetë sepse aty përshkrohet si dy vëndime shtetërore, arti dhe industria, të cilat në mënyrë të rëndësishme mund të egzistojnë pa njëra-tjetrën: pa nivel artistik nuk hyjnë në punë edhe zgjidhjet më të përsosura teknike dhe pa nivel të pranueshëm teknik përbëhen egzistencën e vet edhe arti kinematografik. Këtu kjo lidhje që e ndërlidh realizimin e filmave, vëditurion punën e kinematistëve, arti i të cilëve varet nga një mori arsenalesh teknike sahtu sic varet edhe nga cilësia e punës së një kolektivi të tërë bashkëpunuesish, teknikësh, punëtorësh e aktorësh, duke qenë kështu në të njëjtën kohë arti më kolektiv dhe më i kushtueshëm.

Ja përse një organizim më i mirë, një shpërndarje sa më optimale i aftësive njerëzore dhe arsenalit teknik, jo vetëm njëjll filma më të mirë, por hap edhe mundësi të gjera për shkurtimin e shpenzimeve të cilat mbuloohen nga shteti. Këtu u përqendruan edhe diskutimet, propozimet, studimet e shumta që pasuan vendimet e të gjitha plenumëve të fundit të Partisë dhe të cilat në një formë të vetme gjithë strukturën e sistemit kinematografik, realizimi i së cilës do ta çojë padyshim përpara kinematografinë tonë, duke ngritur nivelin artistik, duke vënë në raporte më të drejta punën dhe shpërblyerjen e të aftëve e të pasitëve, të punëtorëve dhe të dëmbelëve e duke e zvogëluar gjithnjë e më shumë barrën e buxhetit shtetëror e poe jo për të arritur një ditë, nëoqhta jo të largët, në shndërrimin e kinematografisë sonë në një aktivitet rentabilë e fitimprurës. Për t'u futur në këtë rrugë ajo do të fillojë të zbatohet shkallë-shkallë e sektor mbas sektori mekanizimin e ri ekonomik, me kalimin në logarit më vetë. Do të fillojë kjo punë nga baza, nga kinematistë të cilat janë në fund të fundit destinacioni final i çdo veprë filmike.

TEMPUJ KULTURE

Në vendin tonë kinemaja vazhdon të luajë rol të rëndësishëm dhe filmat ndiqen në përgjithësi mirë. Sipas statistikave që shpërndarë shkon në kinema mesatarisht afro tre herë në vit, mesatare kjo më e lartë se në vende të tilla të zhvilluara si Itali, Angli, Gjermani etj. Tek në televizion nuk ka

ndihuar në mënyrë të ndjeshme në shtimin e frekuencimit të filmat, bërë nga një arsë si ndihmon në popullarizimin e tij. Megjithatë, në bazë të studimeve të bëra rezultoi se nëqoftëse gjendja e shtavës të kinomave do të ishte më korode, kushtet teknike të projektimit më të mira, shërbimi i personelit dhe propagandimi në nivel më të lartë, do të krijon një rrjetë të ndjeshme të frekuencimit të kinemave. Kjo, përveç ndikimit të vet në edukimin estetik të masave, do të sillte edhe rritjen e të ardhurave financiare.

Ehtë për të ardhur këq që në shumë rrethe, bërë deri para pak kohësh edhe në Tiranë, niveli arimor e kulturor i punonjëseve të shërbimit të kinemave ishte tepër i ulët, interesimi i komiteteve ekzekutive, spontan e herë-herë krejt i pamjaftueshëm, lidhjet e interesave të punonjëseve me frekuencimin, të zbehta e përparësi shumë salla kinemash të lëndë përshpërndarjen e institucioneve të braktisura ose në rastin më të mirë të atyre të kategorisë së ulët. Dikur kinematistë kishin edhe gardëroba për stinën e dimrit, ngrohje qoftë edhe të pjesëshme, rregulla rigorozë të frekuencimit, baze të vogla ku mund të kalojë kohën e shkurtrë para shfaqjes duke përtypur një kaçub bajnime apo duke pirë një aranzhament e pie jo edhe një kafë. Sot të gjitha këto duken si ëndrra të para nëpër filma». Kjo rritje e kulturës së shërbimit, si edhe rregullimi e rinovimi teknik të shtavës për një kohë të gjatë, sigurisht nga ana e vet edhe ardhja e televizionit, e «kësaj kinemaje në shtëpi», sollën largimin nga sallat e kinemave të spektatorit më të pjekur e më të formuar që, vetvetiu, i jepin shfaqjes së filmat një seriozitet më të madh e shtrirte para saj kërkese më të ngritura.

Po kështu sistemi i deritimit të lidhjes së sektorit të Kinofikimit të Kinostudios me kinematë ka reduktuar përgjegjësitë e të partit thjesht në ndihmën metodike-teknike për të dytët, pa patur asnjë ndërvarje financiare midis të dy paleve. Sistemi i ri që propozohet i jep fund kësaj situatë. E para, krijimi i degëve të filmat nëpër rrethe (për të cilat tashmë është marrë vendimi përkatës i Komitetit të Kulturës dhe Arteve) dhe kalimi i tyre në logarit më vetë i bën të interesuar direkt për frekuencimin të gjithë punonjësit e kinemave, ndaj të cilëve janë

(vijon në f. 2)

Viktor Gjika

NE KETE NU Koha dhe lex janë të përje



DHIMITER

Koha që jetojmë sot me për të shkruar, sipas shtat e mbushur me një që përshën thellin e artit e miltëjobën e të vash

Vështrim mbi autorë d

DALAN



„Të gjithë duan të shtari, dhe kanë të d ajo çka si sajton me dje me të gjithë. N takuar gjithë lexuesit të mençurit e famik krejt lexuesit e tjerë i shtari guxon t'ua bë shtirë.

Një autor një famë

Shtypi i huaj për dhe çësia e shokut njohur Domenik Fe Pjerr Morri në faq vistave.



Adriatik Kallulli, 2002: 'me perjashtime të vogla, kritika (letraro-artistike) ka qenë për dhjetëvjetëshën me rradhë shërbëtoresh e monizmit. Dicka e shëndoshë nisi të dukej në fillim të viteve '60 mandej edhe në fillim të viteve '70, por gjithësesi ruli shtypës shumëtonësh i burokracisë së egër dhe tepër diabolike sheshoi dhe rrafshoi edhe prirjet artistike, edhe prirjet kritike'.

- **Përfundime**
- Media, përmes gazetës "Drita", ka luajtur një rol kyç në formësimin e një segmenti të opinionit publik (edukatorë, intelektualë të fushës së kulturës kryesish) për kinematografinë shqiptare të realizmit socialist gjatë periudhës së diktaturës komuniste në

Shqipëri. Edhe pse ndikimi i saj mbi vendimmarrjen direkte të kineastëve mund të ketë qenë i kufizuar, "Drita" u shndërrua në një mekanizëm të fuqishëm propagandistik që ushqente opinionin publik dhe njëkohësisht ushtronte dhe imbante në presion permanent krijuesit e letërsisë dhe arteve.

- Roli i gazetës Drita si propaganduese e parimeve të realizmit socialist dhe mbrojtëse e vijës ideologjike të Partisë në pushtet u manifestua në dy mënyra kryesore: së pari, përmes promovimit të normave ideologjike dhe glorifikimit të veprave që i përmbushnin ato; së dyti, përmes kritikës së ashpër dhe ndëshkimit moral e profesional të çdo devijimi nga kornizat e pranuar.
- Artikujt e publikuar në "Drita" shpesh shërbenin si udhëzime indirekte për kineastët, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi atë që pritej nga arti dhe kultura, e duke dekurajuar çdo tendencë për eksperimente artistike që nuk përputheshin me ideologjinë zyrtare.
- Në dinamikën komplekse mes medias dhe artit, "Drita" shfaqet jo thjesht si një media kulturore, por si një instrument kontrolli ideologjik, që ndihmoi në ruajtjen e status quo-së dhe orientimin e krijimtarisë artistike drejt qëllimeve propagandistike të regjimit. Në këtë kontekst, *media framing* u bë një vegël e fuqishme për të kontrolluar narrativën publike dhe për të krijuar një mjedis censurues e njëkohësisht nxitës për respektimin e rregullave të rrepta ideologjike.
- Vërehet një refuzim, rezistencë dhe hezitim për të folur për të kaluarën në gazetën Drita dhe film, me disa përjashtime. Por edhe atëherë kur flitet ka rezerva dhe një tendencë përgjithësuësese, duke anashkaluar zbërthimin e fenomenit deri në detaje.